



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Kuvendi i Komunës së Vitisë
Skupstina Opstine Vitina
Municipal Assambly Viti

KOMUNA E VITISË

THIRRJE PUBLIKE PËR MBROJTJEN E PRONAVE PRIVATE TË KOMUNITETIT KROAT

Komuna e Vitisë ju bënë thirrje të gjithë atyre që jetojnë në fshatin Letnicë dhe fshatrave për rreth, në veçanti të zhvendosurave nga Republika e Maqedonisë së Veriut që jetojnë në fshatin Letnicë e Vernakollë që të ruajnë pronën e komunitetit jo shumicë kroat në fshatrat e komunës së Vitisë.

Banorët vendor të Letnicës u treguan solidar duke pranuar në fshatrat e tyre ish refugjat të luftës prandaj mikpritja e tyre duhet respektuar dhe çmuar duke mbrojtur pronat e tyre private.

Kërkojmë nga qytetarët tanë pa dallim etnie që të bashkëpunojnë me autoritetet vendore dhe në rast që hasin në dëmtim të pronave private të lajmërojnë sa më parë policinë apo gjykatën. Gjithashtu Komuna e Vitisë kërkon nga organet përgjegjëse që rastet e dëmtimeve dhe uzurpimeve të pronave private të trajtohen me shpejtësi dhe që kjo dukuri negative të mos tolerohet.

Komuna e Vitisë, mbetet e vendosur që qytetarëve të saj pa dallime, të ju siguroj kushte dhe mjedis të qetë dhe të sigurt për jetë, prandaj çdo rast i dëmtimit të pronave private pa marrë parasysh se ku ndodh brenda juridiksionit të komunës së Vitisë do të merret si shkelje ligjore dhe duhet të marrë dënimin e merituar.

Sinqerisht
Kryetari i Komunës së Vitisë
Sokol Haliti

